



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_935\_05\_13**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 25.02.2013.

**në seancën e mbajtur më datë 28 qershor 2013, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I **APROVOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin D.B. (shifra e konsumatorit: DPR – 29504) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **SHFUQIZOHET** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_892\_01\_13 i datës 17.01.2013.

**Arsyetim**

Konsumatori D.B. me datë 03.04.2012 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatori në KEK lidhur me kontestimin e borxhit deri më datën e blerjes së banesës 27.03.2012.

Me datë 02.11.2012 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se kësaj shifre i është kontestuar shuma prej 1131.83€, duke u bazuar në protokollin e dorëzimit të çelësave.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut me datë 13.11.2012 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka shqyrtimin e ankesës dhe me datë 17.01.2013 ka nxjerr vendim duke e **refuzuar** ankesën e konsumatorit.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 25.02.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi. Në ankesën e konsumatorit theksohet se vendimi i DMK është i padrejtë dhe në kundërshtim me ligjet pozitive. Konsumatori në ankesë ka theksuar se sipas LMD detyrimi i krijuar sipas kontratës mbi shfrytëzimin e shërbimeve të energjisë detyrimisht rrjedhin vetëm në mes kreditorit (KEK) dhe debitorit (shfrytëzuesit të shërbimit). Sipas kësaj debitor i KEK-ut deri me datë 26.03.2008 është J. B. dhe se pas datës 27.03.2008 D. B. është shfrytëzues faktik i kësaj shifre, andaj shpenzimet deri më datën 26.03.2008 janë krijuar nga J. B.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28 qershor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se konsumatori D. B. me shifër DPR – 29504 ka kundërshtuar borxhin e energjisë



elektrike deri në periudhën 03/2008. Bordi po ashtu ka vërejtur se KEK-u me datë 02.05.2012 ka kontestuar borxhin e energjisë elektrike në vlerë prej 1,131.83€ sipas protokollit mbi dorëzimin e çelësave të datës 01.08.2003.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe protokollin mbi dorëzimin e çelësave të lëshuar nga Drejtorati për çështje pronësore dhe banesore (tani i njohur me emrin Agjensioni Kosovar për Prona) dhe ka vërejtur se konsumatori (pronarja legjitime në atë kohë) me datë 01.08.2003 i ka marrë çelësat e banesës nga Agjensioni Kosovar për Prona. Është analizuar edhe Neni 1 i Urdhëresës Administrative 2004/2, si dhe neni 2 i Urdhëresës Administrative nr. 2008/5 në të cilën theksohet: borxhi i krijuar i mëhershëm nga persona që e kanë shfrytëzuar banesën në formë jo-legale ose gjatë periudhës së shfrytëzimit legjitim nga ndonjë person ndryshe nga bartësi legal i pronës sipas skemës qiradhënëse të Agjencionit Kosovar për Prona, ky borxh nuk do t'i ngarkohet personit i cili është përcaktuar si pronar i ligjshëm nga Agjensioni Kosovar për Prona.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_892\_01\_13 të datës 17.01.2013 dhe ka vërejtur se DMK është bazuar në nenin 2 të Urdhëresës Administrative nr. 2008/5 në të cilën theksohet se: *“borxhi i krijuar i mëhershëm nga persona që e kanë shfrytëzuar banesën në formë jo-legale ose gjatë periudhës së shfrytëzimit legjitim nga ndonjë person ndryshe nga bartësi legal i pronës sipas skemës qiradhënëse të Agjencionit Kosovar për Prona, ky borxh nuk do t'i ngarkohet personit i cili është përcaktuar si pronar i ligjshëm nga Agjensioni Kosovar për Prona”*, ku konsumatori posedon edhe Protokolin e dorëzimit të çelësave nga Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banësore, dhe se në kontratën e shitblerjes së mes K. P. dhe D. B. të datës 27.03.2008 nuk është përpiluar asnjë dispozitë ligjore ku do të bëhej definimi se kush bart shpenzimet e energjisë elektrike të krijuara deri me datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar kontratën mbi shitblerjen e shtëpisë mes D. B. dhe K. P., me adresë “Haxhi Zeka” me sipërfaqe prej 1,50 ari, në shfrytëzim të përhershëm oborin me sipërfaqe prej 2, 51 ari, ku gjithsejtë në sipërfaqe prej 4,01 ari të evidentuar si ngastër nr. 3778 sipas fletës poseduese nr. 2967 ZK Prishtinë, dhe ka vërejtur se kjo kontratë për shitblerje është e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 27.03.2008. Gjatë analizës së kësaj kontrate Bordi i ZRRE-së thekson se neni 2 i kontratës e mbulon definimin e bartjes së shpenzimeve të energjisë elektrike, pra sipas këtij neni deri me datën e nënshkrimit të kontratës 27.03.2008 shpenzimet i bart shitësi ndërsa pas datës së nënshkrimit të kontratës i bart blerësi.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se neni 2 i kontratës mbi shitblerjen e shtëpisë e nënshkruar mes K. P. dhe D. B. e mbulon definimin se kush i bart shpenzimet, e në rastin konkret të shpenzimeve të energjisë elektrike dhe se ankesa e konsumatorit ndaj vendimit të DMK-së aprovohet.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.06.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_892\_01\_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar